

Njoftim për Media

Tiranë, më 27 Shtator 2023: Instituti i Statistikave (INSTAT) njofton median dhe opinionin publik se Censi i Popullsisë dhe Banesave, i cili ka filluar në datën 18 Shtator 2023, po ecën sipas parashikimeve.

Asnjë problematikë thelbësore nuk është shfaqur gjatë këtyre ditëve dhe angazhimi i INSTAT është maksimal për t'i garantuar çdo qytetari në Republikën e Shqipërisë të drejtën për t'u numëruar.

Nga informacionet paraprake në terren, qytetarët i janë përgjigjur pozitivisht thirrjes për të marrë pjesë në Cens në të gjithë territorin e Shqipërisë.

Drejtoresha e Përgjithshme e INSTAT, Znj. Elsa Dhuli, thekson se: “Deri më tani nuk kemi hasur në asnjë problematikë apo ankesë të qenësishme për mbledhjen e të dhënave në terren. INSTAT përveç stafit të angazhuar për mbledhjen e informacionit në terren (anketues, kontrollorë dhe mbikqyrës) ka angazhuar dhe punonjësit e shërbimit civil të INSTAT për të monitoruar dhe dhënë zgjidhje problematikave potenciale në një proces statistikor kaq kompleks siç është Censi i Popullsisë dhe Banesave. Dua të theksoj që ky është një proces totalisht teknik dhe informacioni i mbledhur nga të gjithë familjet shqiptare është konfidencial dhe i garantuar nga ligji “Për statistikat zyrtare” dhe ligji i “Censit të Popullsisë dhe Banesave”. Kësisoj, dua të sjell në vëmendje që detyrimi për t’iu përgjigjur anketuesve të INSTAT është detyrim ligjor dhe sigurisht një e drejtë qytetare për të kontribuar në zhvillimin e vendit duke marrë reforma dhe politika bazuar në shifra të sakta”.

Çdo pretendim apo ankesë e çdo qytetari të cilit mund t’i jetë cënuar e drejta për t’u numëruar apo përgjigjur pyetjeve sensitive mbi etninë, fenë dhe gjuhën amtare mund të kontaktojnë në numrin jeshil të vendosur nga INSTAT ([0800 22 44](tel:08002244)) ku deri tani ju informojmë se nuk ka pasur ankesa të tilla nga qytetarët.

Gjithsesi, u shpreh Dhuli: “Mirëpresim çdo ankesë konkrete nga çdo individ, por theksoj se insinuatat dhe akuzat në ajër nuk e ndihmojnë procesin”.